



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Pastrim parash? Agron Shehaj e bleu vilën 2.9 miliona euro në 2021, e shiti 15 milionë euro në 2025
- 2

çështjes
- 3

'Arresti me burg' i Veliajt në Gjykatën e Lartë, lin Panda dorëhiqet si relator i S'ishim në lartësinë e duhur! Ikën Deschamps, vjen Zinedine Zidane
- 4

Botërori/ Franca e shkatërruar pas eliminimit, Maspepe e mbijli me 0 trofe: kilogramësh (VIDEO)
- 5

Gjuetia spektakolare, peshkatar në Vlorë fiton përleshjen nën ujë, kap peshkun 27
- Amnistia penale, Gogu: Përqafime që flasin më shumë se fjalët! Pas çdo

Kronikë

Fushë-Krujë/ Drogë e organizim i paligjshëm i lojërave të fatit, në pranga një efektiv policie e 2 persona të tjerë (EMRAT)

Gjatë kontrollit në banesën e efektivit të policisë, u gjet e u sekuestruan 119 fishekë model 9mm ndërsa në objektin e dy të arrestuarve u sekuestruan pajisje elektronike, qese paketimi për lëndë narkotike, servera, e materiale të tjera.

Drogë dhe lojëra fati, arrestohet një efektiv dhe 2 të tjerë

Report TV



Watch on

[Sh.com] Redaksia 8 Korrik, 09:49 | Përditësimi: 8 Korrik, 13:45

f Share Post



Një punonjës së Policisë së Shtetit është arrestuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore i akuzuar për shpërdorim detyre e organizim të paligjshëm ose ushtrim i lojërave të fatit.

Lutfi Dervishi me detyrë Ndhimës Specialist i Policimit në Komunitet, mbulon qytetin e Fushë-Krujës ku dy persona të tjerë, gjithashtu të arrestuar, ushtronin veprimtarinë e paligjshme.

Të arrestuar janë **Sabah Stafuga** dhe **Fatmir Stafuga** të akuzuar për veprat penale “Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.



LEXO EDHE: Thyen ‘arrestin në shtëpi’ dhe vjedh me dhunë farmacinë! 45-vjeçari prangoset pas disa orësh! Momenti kur i sulet farmacistes në befasi (EMRI+VIDEO)

Gjatë kontrollit në banesën e efektivit të policisë, u gjet e u sekuestruan 119 fishekë model 9mm ndërsa në objektin e dy të arrestuarve u sekuestruan pajisje elektronike, qese paketimi për lëndë narkotike, servera, e materiale të tjera.

Njoftimi i AMP

Në vijim të operacionit të koduar “Basti i Fundit”, si rezultat i veprimeve hetimore dhe procedurale të kryera, u arrestuan në flagrancë një punonjës policie dhe dy shtetas.

Lutfi Dervishi me detyrë Ndhimës Specialist i Policimit në Komunitet, me zonë mbulimi qytetin e Fushë-Krujës, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 197 të Kodit Penal.

Gjatë kontrollit në banesë iu gjetën 119 fishekë model 9mm.

Sabah Stafuga, banues në Arrameras, Fushë-Krujë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, i padënuar më parë.

Fatmir Stafuga, banues në Arrameras, Fushë-Krujë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare.

Arrestimi i shtetasve Sabah Stafuga dhe Fatmir Stafuga u krye për veprat penale “Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuara nga nenet 197 dhe 283 të Kodit Penal.

Gjatë kontrollit të ushtruar në ambientet objekt hetimi, në cilësinë e provës materiale u sekuestruan:

* 4 pajisje elektronike (makineta) të dyshuara për ushtrimin e lojërave të fatit;

* 2 serverë/njësi kompjuterike, të dyshuara se përdoreshin për aktivitetin e kundërligjshëm;

* 1 pajisje DVR;

* 5 qese me mbështjellje plastike, që përmbanin lëndë të dyshuar narkotike, me peshë totale 2.22 gramë;

* 6 qese të vogla plastike, që përmbanin lëndë të dyshuar narkotike, me peshë totale 4.41 gramë;

* 3 aparate telefonike celulare.

Veprimet hetimore vijnë për dokumentimin e plotë të veprimtarisë së kundërligjshme, identifikimin e personave të tjerë të mundshëm të përfshirë, si dhe evidentimin dhe dokumentimin e çdo rasti të favorizimit, mbështetjes apo mosveprimi nga punonjës të strukturave ligjzbatuese.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore mbetet e vendosur në përbushjen e përgjegjësi të saj ligjore, duke zbatuar standard të barabartë përpara ligjit dhe tolerancë zero ndaj çdo punonjësi që, në kundërshtim me detyrën dhe përgjegjësinë publike, përfshihet, favorizon apo mbështet veprimtari të kundërligjshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

K.B/E.H/Shqiptarja.com

TAG: AMP Fatmir Stafuga Sabah Stafuga Lutfi Dervishi lojera fati Durrës fushe kruje

Komento

Komente

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: Si e vlerësoni vendimin e PD për të bojkotuar seancat plenare? 14 Korrik, 12:01

Të drejtë Të gabuar Nuk e di

Lajme të tjera



Posta Shqiptare kallëzon punonjësit, dyshohet se vodhën mbi 700 mijë euro në filialin në Durrës! Shkarkohet drejtoresha 14 Korrik, 14:04



Plagosja e 22-vjeçarit në Fushë-Krujë, arrestohet autori! I gjendet edhe thika me të cilën kreu krimin (EMRI) 14 Korrik, 10:10



Sherr me thika mes të rinjve në Fushë-Krujë, 22-vjeçari përfundon te Trauma (VIDEO) 13 Korrik, 21:43



Blllokohen 110 litra verë e padeklaruar në portin e Durrësit, shoferi gjohet me trefishin e detyrimit 13 Korrik, 12:51



Kultivonin kanabis, pranga 31-vjeçarit në Krujë, në kërkim bashkëpunëtori (VIDEO) 13 Korrik, 09:15




IGJEUJ paralajmëron: Sot, situata më kritike nga zjarret! 6 qarqet me rrezik më të lartë 11 Korrik, 16:04




Zbulohen 3 lokale të kthyer a në baze për lojëra fati në Tiranë, 2 në pranga, 2 në kërkim! 4 të rinj të hetim (VIDEO) 11 Korrik, 10:10



Arratisja e një personi nga ‘arresti i shtëpisë’, AMP arreston efektivin e Policisë në Dibër për shpërdorim detyre: Nuk kreu veprimet hetimore! 10 Korrik, 20:51



Porti i Durrësit përgatitet për fluksin e verës, targetet drejt Italisë nisën lundrimet e dyfishta nga kjo fundjavë 10 Korrik, 15:45



Në kërkim për vrasje e plagosje nga Maqedonia e Veriut, arrestohen 2 të rinjtë në Durrës! Në pranga edhe një tjetër (EMRAT+VIDEO) 10 Korrik, 12:35



Operacioni për tjetërsimin e pronave në Durrës, sekuestrohen 80 mijë metra katrorë tokë 10 Korrik, 10:54




Durrës/ 40-vjeçari plagos me thikë bashkëshorten, shpallet në kërkim 10 Korrik, 09:21

[Sh.com] Lajmi i fundit

Pastrim parash? Agron Shehaj e bleu vilën 2.9 milionë euro në 2021, e shiti 15 milionë euro në 2025

15 Korrik, 14:46 nga Adriatik Doci

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju



[illegible]